



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 192, datë 20.05.2022**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Përrjashtim gjyqtari.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Suela Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...} etj.; Akuza: Neni 283/2 i Kodit Penal.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...} vetj.; Akuza: Nenet 140, 25, 278/5 të Kodit Penal.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...} ndaj {...} etj.; Objekti: Dërgim në gjyq.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi (relator), Artan Çupi dhe Suela Lika, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...} etj.; Akuza: Nenet 283/2 dhe 284/2 të Kodit Penal.

6. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi (relator), Suela Lika dhe Murat Lleshi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 88, 140 dhe 278/1 të Kodit Penal.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Suela Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Heqje zotësie për të vepruar.

8. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 143/3 i Kodit Penal.

9. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka dhe Xhevdet Lika, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen civile me Paditës: {...} etj.; Të paditur: {...}, etj; Objekti: Detyrim njohje pronar.

10. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Nertila Kape, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, {...}; Objekti: Pavlefshmëri kontrate.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Adelajda Gjuzi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal.

### **GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Migena Laska (relatore), gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Matilda Llangozi dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin Aurel Arapi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, etj.; Të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 298/3, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka (relator), gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Esmeralda Xhili si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Alma Kolgjoka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 283/a/1 e 22, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

### **GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Alma Ahmeti dhe Fatri Islamaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; I akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 298/3, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të K.Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**